

SQARIM

Nga: NJËSIA E PROKURIMIT e A.K. ALBGAZ Sh.a.

Në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur/ Shërbime/ Me mjete elektronike” me objekt prokurimi: “Evidentimi në terren dhe vlerësimi teknik i integritetit të linjave teknologjike dhe tubacioneve nëntokësore të shoqërisë Albgaz sh.a. dhe vlerësimi i thelluar i ndikimit në mjedis të tyre, për efekt të pajisjes me Lejen Mjedisore”, me numër reference Nr. REF-50947-02-19-2020, në S.P.E. e A.P.P., ju sqarojmë si më poshtë vijon;

Tek Shtojca 8 e D.T.-Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.4 - Disponimi i mjeteve/pajisjeve të mëposhtme, tek Pronësia - faqja 32, ku kërkohet:

“.. **Pronësia** e mjeteve të mesiperme të vertetohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të paraqesë për automjetet të cilat janë në pronësi, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm, taksat vjetore.

Për aparatet Ofertuesi duhet të paraqesë **kontratë noteriale të blerjes (nëse ka)** të shoqëruar me fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të aparatit...”

Për sa më sipër për sa i përket kërkesës për paraqitjen e **kontratës noteriale të blerjes (nëse ka)**, ne si A.K. Albgaz Sh.a. sqarojmë se kontrata e blerjes midis palëve **mund të jetë lidhur para noterit ose jo.**

Pra edhe në rastin kur kjo kontratë blerje nuk është lidhur para noterit ky dokument do merret në konsideratë në procesin e vlerësimit të ofertave eventuale që do paraqiten nga O.E.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

PËR NJËSINË E PROKURIMIT
Personi Përgjegjës për Prokurimin